REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**

**K.P.P. 241/2020**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|---|---|
| Enkeleda Bega | Nënkryetar |
| Vilma Zhupaj | Anëtar |
| Lindita Skeja | Anëtar |
| Merita Zeqaj | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 07.07.2020, shqyrtoi ankesën me:

**Objekt**: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e shoqërisë "Alpen Pulito" sh.p.k në procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur", me Nr.REF-55708-04-06-2020, me objekt: "*Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendëshme dhe të jashtme të Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë*", me fond limit 76,876,340.6 leke pa tvsh, zhvilluar me date 30.04.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e shoqërive "Alpen Pulito" sh.p.k, "Clean Fast" sh.p.k, "Rej" sh.p.k, "Sanitary Cleaning" sh.p.k dhe "Pastrime Silvio" sh.p.k në procedurën e prokurimit.

**Ankimues:** "Clean Fast" sh.p.k
Blv "Bajram Curri", Godina ETC, Kati 13, Tiranë

"Sori - Al" sh.p.k
Rruga "Beqir Luga", Pallati nr.3, Shk. 1/1, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara
Sheshi Skenderbej, Nr. 3, Tiranë

**Subjekte të Interesuar:** "Alpen Pulito" sh.p.k
L.14, Rr.Tirana, Shkozet, Z.K.8516, Nr. pasurie 16/201, Kati I, Durres

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik",* i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *"Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik".*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2 Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*";

I.4. Kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 07.04.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit "Procedurë e hapur", me Nr.REF-55708-04-06-2020, me objekt: "*Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendëshme dhe të jashtme të Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë*", me fond limit 76,876,340.6 leke pa tvsh, zhvilluar me date 30.04.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 19.05.2020 operatorët ekonomikë ankimues janë njoftuar elektronikisht për skualifikimin e tyre nga procedura e mësipërme e prokurimit si më poshtë vijon:

1. “Alpen Pulito” sh.p.k 47.283.330,00 lekë, kualifikuar
2. “Leka-2007” sh.p.k 55.166.400,00 lekë, skualifikuar
3. “Clean Fast” sh.p.k 59.103.548,00 lekë, kualifikuar
4. “Rej” sh.p.k 59.219.330,00 lekë, kualifikuar
5. “Sanitary Cleaning” sh.p.k 69.760.322,00 lekë, kualifikuar
6. “Pastrime Silvio” sh.p.k 69.874.328,00 lekë, kualifikuar
7. “Cogren” sh.p.k 70.008.801,00 lekë, skualifikuar
8. “Sori Al” sh.p.k 76.068.263,00 lekë, kualifikuar
9. “KPL” sh.p.k 76.772.804,20 lekë, skualifikuar

II.3. Në datën 22.05.2020, operatori ekonomik “Clean Fast” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, me anë të së cilës kundërshton kualifikimin e shoqërisë “Alpen Pulito” sh.p.k në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr.REF-55708-04-06-2020, me objekt: “*Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendëshme dhe të jashtme të Spitalit Psikiatrik “Ali Mihali” Vlorë*”, me fond limit 76,876,340.6 leke pa tvsh, zhvilluar me date 30.04.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara. Konkretisht pretendohet si vijon:
*“ [...]Ne si shoqeria ankuese pretendojme se shoqeria "Alpen Pulito" shpk duhej skualifikuar per arsyet e meposhtme:*
*Me shpalljen e kesaj procedure prokurimi nga Agjencia e Blerjeve te Perqendruara u publikuan edhe kriteret e pergjithshme te pranimit/kualifikimit (shtojca nr. 8). Nga krahasimi i ketyre kritereve me dokumentacionin dhe oferten e dhene nga shoqeria "Alpen Pulito" shpk, konstatojme se kjo shoqeri nuk ploteson kriteret e pergjithshme te pranimit/kualifikimit te percaktuara ne shtojcen nr.8, dhe konkretisht:*
*Se pari: Ne piken 3.2 te shtojces nr.8 te kritereve te pergjithshme te pranimit/kualifikimit te titulluar "Kapaciteti ekonomik dhe financiar", kerkohet qe:*
*1. Kopje te deklaratave te xhiros vjetore ose vertetim nga administrata tatimore, per xhiron e realizuar ne vitet 2016,2017 dhe 2018, vlera mesatare e te ciles te jete jo me e vogel se 40% e vleres se fondit limit.*
*2. Kopje te certifikuara te bilanceve te viteve: 2016, 2017, 2018, te paraqitura prane autoriteteve perkatese tatimore.*
*Operatori ekonomik shoqeria "Alpen Pulito" shpk, nuk i ploteson kushtet e mesiperme te percaktuara ne pikat 1 dhe 2. Konkretisht referuar deklarimeve te shoqerise "Alpen Pulito" shpk ne QKB rezulton se ajo ka nje xhiro te realizuar ne vitet 2016, 2017 dhe 2018, vlera mesatare e te ciles eshte me e vogel se 40% e vleres se fondit limit, nderkohe qe kerkohet qe kjo xhiro duhet te jete mbi 40% e vleres se fondit limit. Keshtu ne keto tre vite shoqeria "Alpen Pulito" shpk ka deklaruar xhirot e meposhtme:*
*Viti 2016-Xhiro Vjetore 34.912.439*
*Viti 2017 - Xhiro Vjetore 25.867.759*
*Viti 2018-Xhiro Vjetore 30.203.428*
*Mesatarja e ketyre xhirove eshte 30.327.875 pra me e vogel se 40% e fondit limit pra e vleres 30.750.536,24.*
*Po keshtu shoqeria "Alpen Pulito" shpk nuk i ka te certifikuara bilancet e viteve: 2016, 2017, 2018, te paraqitura prane autoriteteve perkatese tatimore. Pra shoqeria "Alpen Pulito" shpk*

*nuk ploteson asnje nga kriteret e kerkuara ne piken 3.2 te shojces nr.8 te kritereve te pergjithshme te pranimit/kualifikimit te titulluar "Kapaciteti ekonomik dhe financiar".*

*Se dyti: Ne piken 3.3 te kritereve te pergjithshme te pranimit/kualifikimit te titulluar: Kapaciteti teknik, eshte kerkuar qe:*

*1. Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per sherbimet e meparshme te ngjashme te kryera gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e zhvillimit te procedures, ne vleren jo me pak se 40% e vleres se fondit limit.*

*Rezulton se shoqeria "Alpen Pulito" shpk nuk e ploteson kete kriter pasi ajo nuk ploteson xhiron ne kete vlere (tek xhiro e nje shoqerie futen edhe kontrata te tjera per sherbime jo si ky qe kerkohet ne proceduren e prokuruar) e jo me kontrata te meparshme te ngjashme me vlere sa 40% e vleres se fondit limit.*

*Po keshtu ne piken 3.3 te kritereve te pergjithshme te pranimit/kualifikimit te titulluar: Kapaciteti teknik, eshte kerkuar qe shoqeria te kete te pakten 15 punonjes te pajisur me librezat shendetesore ne fushen e pastrimit, kjo edhe ne kuader te Covid 19. Rezulton se shoqeria "Alpen Pulito" shpk nuk e ploteson kete kriter.*

*Se treti: Ne piken 5 te kritereve te pergjithshme te pranimit/kualifikimit kerkohet qe operatori ekonomik duhet te provoje se disponon: Kazane plehrash teknologjike (me mekanizem), minimuni 6(gjashte) cope. Rezulton se shoqeria "Alpen Pulito" shpk nuk e ploteson kete kriter.*

*Se katerti: Ofertuesi "Alpen Pulito "shpk, nuk ploteson kriterin per dorezimin e certifikatave ISO 9001- 2008/ISO 9001 -2015; ISO 18001;2007; ISO 14001 :2004/ ISO 14001 :2015, pasi certifikatat nuk jane leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura ne Republiken e Shqiperise.*

*Se pesti: Oferta e paraqitur nga ofertuesi "Alpen Pulito "shpk, eshte oferte anoMalisht e ulet dhe si e tille duhej skualifikuar. Konkretisht: Mesatarja e Ofertave te vlefshme eshte: Mo= 63.551.520,16. Pra, Zbritja e Mundshme eshte: ZM = 54.018.791,85*

*Pra Zbritja e Mundshme eshte 54.018.791,85 nderkohe qe oferta e paraqitur nga operatori ekonomik shoqeria "Alpen Pulito" shpk eshte 47.283.333 leke, pra me e vogel se Zbritja e Mundshme me nje diference prej 6.735.461,85 nga Zbritja e Mundshme, rrjedhimisht eshte nje oferte anomalisht e ulet dhe si e tille duhet skualifikuar.*

*Sipas nenit 56 te Ligjit per Prokurimet Publike kur autoriteti kontraktor veren se nje oferte eshte anomalisht e ulet, ai, perpara se te vazhdoje me procesin e vleresimit te ofertave, i kerkon operatorit ekonomik perkates te paraqese me shkrim dhe brenda 3 diteve pune shpjegime per elemente te vecanta te ofertes, per:*

*a) anen ekonomike te metodes se sherbirneve te ofruara;*

*b) zgjidhjet teknike te ofruara dhe/ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshern, qe ka ofertuesi per kryerjen e sherbimeve;*

*c) origjinalitetin e sherbimeve, te propozuara nga ofertuesi;*

*9) zbatueshmerine e detyrimeve, qe lidhen me mbrojtjen nc pune dhe kushtet e punes, ne vendin ku do te kryhet puna, sherbirni apo ku do te sigurohet furnizimi.*

*Pra ne kete rast duhet qe enti prokurues ti kerkoje shoqerise "Alpen Pulito" shpk, shpjegime per elementet e ofertes se paraqitur ne 5 drejtimet e permendura me siper. Enti prokurues duhet te kete parasysh shtojcen 8, Kriteret e vecanta te kualifikimit, pika 3.3 kapaciteti teknik, kerkohet*

*qe ky sherbim te ofrohet minimalisht nga 15 punonj es pastrimi duke pasur parasysh se sherbimi i pastrimit ne spital eshte nje sherbim ku punonjesit nuk mund te paguhen me page minimale, duhet te mbahet parasysh qe paga minimale cdo vit percaktohet nga Keshilli i Ministrave me trend rrites. Duhet te kete parasysh shtojcen 9 qe sherbimi i pastrimit te kryhet me 3 turne, cfare do te thote se pastrimi do te kryhet 24 ore me tre turne ne 7 dite te javes. Kjo dote thote se do te kryhet sherbimi i pastrimit edhe ne intervalin orar nga ora 19.00 deri ne oren 6 te mengjesit. Ne nenin 81 te Kodit te Punes parashikohet se:*

*"1. Cdo ore pune e kryer nga ora 19. 00 deri ne 22. 00jep te drejten e nje shtese mbi page jo me pak se 20 per qind.*

*2. Cdo ore pune e kryer midis intervalit 22. 00 dhe 6. 00jep te drejten e nje shtese mbi page jo me pak se 50 per qind".*

*Pra eshte detyrim ligjor qe punonjesit qe do te punojne ne turnin e dyte dhe te trete te paguhen respektivisht me shtese page 20% dhe 50%, cka rrit zerin e shpenzimeve per paga.*

*Po keshtu sherbimi i pastrimit ofrohet 24 ore ne 7 dite te javes, nderkohe qe po sipas Kodit te Punes (nenit 83) kohezgjatja normale e javes se punes eshte 40 ore, ndersa sipas nenit 85 te Kodit te Punes cdo punonjes ka te drejten ligjore te nje dite pushim ne jave, cka ben te domosdoshme pasjen e nje stafi shtese mbi numrin 15 te kerkuar nga enti prokurues per te zevendesuar punonjesit qe bejne pushimin javor, dhe kjo perkthehet ne kosto shtese te zerit te pagave te punonjesve.*

*Po keshtu sikurse u tha me larte, sherbimi i pastrimit ofrohet 24 ore ne 7 dite te javes, nderkohe qe sipas nenit 87 Kodit te Punes punonjesit qe punojne ne diten e pushimit zyrtar apo diten e diel perfitojne nje kompensim ne page jo me pak se 25 %, cka perkthehet ne kosto shtese te zerit te pagave.*

*Por per realizimin e sherbimit te pastrimit nuk kerkohet vetem fuqi punetore, por kerkohen edhe materiale pastrimi, makineri te specializuara per fshirjen e rrugeve, autobot uji per larjen e rrugeve nga muaji prill ne shtator, makine tekonologjike per heqjen e mbeturinave nje here apo dy here ne dite, grup i specializuar per pastrimet gjenerale nje here ne muaj, veshje te vecanta per punonjesit e pastrimit duke filluar nga kepuces e gomes, dorashkat etj,*

*Ne perfundim ne i theksojme entit prokurues se Shoqeria "Alpen Pulito" shpk nuk ka asnje avantazh ne anen ekonomike te metodes se sherbimeve te ofruara, nuk ka asnje zgjidhje teknike ose kusht favorizues te jashtezakonshem per kryerjen e sherbirneve, nuk ka asnje origjinalitet sherbimi, dhe ajo nuk mund ti shmanget zbatueshmerise se detyrimeve, qe lidhen me Kodin e Punes, qe te mund te justifikoje oferten anomalisht te ulet.*

*Per kete kerkojme skualifikimin e ofertes se paraqitur nga shoqeria "Alpen Pulito" shpk dhe shpalljen fitues ne kete procedure prokurimi te Shoqerise "Clean Fast" shpk.*

II.4.1. Nëpërmjet shkresës nr. 884/3 prot., datë 01.06.2020 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke e refuzuar ankesën si vijon:

*"l.Ofertuesi "Clean Fast" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertuesit "Alpen Pulito" SHPK per mospermbushjen e kriterit ne Shtojcen Nr.8 "Kriteret e Vecanta te kualifikimit"*

*seksioni 3.2 "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" pikat 1 dhe 2, ne dokumentet e tenderit ku percaktohet: "1-Kopje te deklaratave te xhiros vjetore ose vertetim nga administrata tatimore, per xhiron e realizuar ne vitet 2016,2017 dhe 2018, vlera mesatare e le ciles te jete jo me e vogel se 40% e vleres se fondit limit.2-Kopje te certifikuara te bilanceve te viteve: 2016, 2017, 2018, te paraqitura prone autoriteteve perkatese tatimore."*

*Me pretendimin si vijon: [ ... ] " .... Operatori ekonomik shoqeria "Alpen Pulito" shpk, nuk i ploteson kushtet e mesiperme te percaktuara ne pikat 1 dhe 2. Konkretisht referuar deklarime te shoqerise "Alpen Pulito" shpk ne QKB rezulton se ajo ka nje xhiro te realizuar ne vitet 2016,2017 dhe 2018, vlera mesatare e te ciles eshte me e vogel se 40% e vleres se fondit limit, nderkohe qe kerkohet qe kjo xhiro duhet te jete mbi 40% e vleres se fondit limit. Keshtu ne keto tre vite shoqeria "Alpen Pulito" shpk ka deklaruar xhirot e meposhtme: Viti 2016 -Xhiro Vjetore 34.912.439 Viti 2017 -Xhiro Vjetore 25.867. 759, Viti 2018 -Xhiro Vjetore 30.203.428. Mesatarja e ketyre xhirove eshte 30.327.875 pra me e vogel se 40% efondit limit pra e vleres 30. 750.536,24.*

*Po keshtu shoqeria "Alpen Pulito" shpk nuk i ka te certifikuara bilancet e viteve: 2016, 2017, 2018, te paraqitura prone autoriteteve perkatese tatimore. Pra shoqeria "Alpen Pulito " shpk nuk ploteson asnje nga kriteret e kerkuara ne piken 3.2 te shojces nr.8 te kritereve te pergjithshme te pranimit/kualifikimit te titulluar "Kapaciteti ekonomik dhe financiar"."*

*Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vleresimin e bere ne sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, dokumentet e dorezuara nga ofertuesi "Alpen Pulito" SHPK, pretendimet e parashtruara ne ankese mbi kualifikimin e ofertes se tij nga ofertuesi "Clean Fast" SHPK konstatoi se:*

*Per ofertuesin "Alpen Pulito" SHPK, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka njoftuar automatikisht nepermjet sistemit te prokurimit elektronik me date 19.05.2020, kualifikimin e tij.*

*Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga Ofertuesi "Alpen Pulito" SHPK dhe konstatoi:*

*Ne dokumentet e tenderit ne Shtojcen Nr.8 "Kriteret e Vecanta te kualifikimit" seksioni 3.2 "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" pikat 1 dhe 2, percaktohet se ofertuesi duhet te dorezoje, kopje te deklaratave te xhiros vjetore ose vertetim nga administrata tatimore, per xhiron e realizuar ne vitet 2016,2017 dhe 2018, vlera mesatare e te ciles te jete jo me e vogel se 40% e vleres se fond it limit si dhe kopje te certifikuara te bilanceve te viteve 2016, 2017, 2018, te paraqitura prane autoriteteve perkatese tatimore.*

*Nga verifikimi i sistemit te prokurimit elektronik rezulton se ofertuesi ne permbushje te kritereve te sipercituara ka dorezuar dokumentacionin me emertim "Vertetim xhiro tre vitet e fundit", "Vertetim xhiro 2016" dhe " Bilancet". Pjese e ketij dokumentacioni eshte vertetimi nr. T02056956 date 15.04.2020 ku jane te pasqyruara vertetimet per xhiron e tre viteve te fundit 17-A, 18-A, 19-A; vertetimi nr. TO 1651708 date 24.12.2019 ku jane te pasqyruara vertetimet e xhiros per periudhen 16- A, 17-A dhe 18-A. Nga verifikimi i dokumentacionit te dorezuar ne permbushje te kriterit te percaktuar ne piken 1 ne seksion 3.2 "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikirnit" rezulton se ofertuesi "Alpen*

*Pulito" SHPK nuk e ka permbushur kriterin. Nga verifikimi i proces verbalit te mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te ofertave rezulton se mos permbushja e ketij kriteri eshte cilesuar devijim i vogel.*

*Sqarojme se:*

*[...]Ne piken 4 te nenit 53 te Ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", te ndryshuar, percaktohet se: "4.Autoriteti kontraktor vlereson nje oferte te vlefshme edhe nese ajo perrnban devijime te vogla, te argumentuara, te cilat nuk ndryshojne thelbesisht karakteristikat, kushtet dhe kerkesat e tjera, te percaktuara ne dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, te cilat mund te korrigjohen pa prekur perrnbajtjen e saj." Pra, komisioni i vleresimit te ofertave mund te konsideroje nje oferte te vlefshme edhe nese: a) ajo perrnban devijime te vogla, te cilat materialisht nuk ndryshojne ose devijojne kushtet dhe kerkesat e tjera, te percaktuara ne dokumentet e tenderit; b) oferta perrnban gabime apo lapsuse, te cilat mund te korrigjohen pa prekur permbajtjen e ofertes. Te gjitha devijimet e tilla dote mblidhen, sate jete e mundur dhe do t'u kushtohet vernendja e duhur ne vleresimin dhe ne krahasimin e ofertave.*

*Ne kete kuptim, nocioni mbi ofertat qe perrnbajne devijime te vogla mund te konsiderohen si te pershtatshrne ne zbatim te LPP, neni 53, pika 4. Ky nocion, referuar ne praktike si "pershtatshmeri thelbesore" e ofertave ndaj kerkesave ne dokumentet e tenderit, bazohet ne dallimin mes "devijimeve te vogla" nga "devijimet rnateriale". Devijime te vogla jane devijimet qe nuk ndryshojne materialisht ose nuk i kalojne specifikimet, kushtet, termat dhe kerkesat e tjera te parashtruara ne dokumentet e tenderit ose gabimet apo pakujdesite qe mund te korrigjohen pa ndryshuar thelbin e tenderit. Devijimet materiale jane devijime nga kriteret e identifikuara te cilat burojne nga kuadri ligjor rregullator (ligjet, aktet nenligjore dhe rregulloret, parimet e menaxhimit te shendoshe financiar ose te sjelljes se zyrtareve publike).*

*Per sa kohe qe nje devijim nga kerkesat e specifikuara dhe specifikimet nuk do te thote trajtim i pabarabarte i ofertuesve dhe ka nje ndikim te paperfillshem ne konkurrencen e lire dhe te ndershme ne mes tyre dhe qe nuk ndikon ne procesin e zbatimit te kontrates, devijimi i tille nuk konsiderohet si "i konsiderueshem". Njesia matese e devijimeve eshte esenciale nese devijimi do ta bente te pamundur krahasimin e ofertave dhe per kete arsye do te ishte i pamundur vleresimi ne menyre te barabarte te ofertuesve. Refuzimi i ofertave me te ulta thjesht per devijime te vogla kufizon konkurrencen, demton ekonomine si dhe efikasitetin e mireperdorimit te fondeve publike.*

*Ne lidhje me dokumentacionin e dorezuar per permbushjen e kriterit te percaktuar ne piken 2 ne seksionin 3.2 "Kapaciteti Teknik" ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" rezulton se ofertuesi e ka permbushur kriterin e percaktuar pasi ka dorezuar bilancet per periudhen 2016, 2017, 2018 dhe keto bilance mbajne vulen e autoritetit perkates tatimore.*

*Per arsyet e me siperme pretendimi i ofertuesit "Clean Fast" SHPK nuk pranohet.*

*2.Ofertuesi "Clean Fast" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertuesit "Alpen Pulito" SHPK per mospermbushjen e kriterit ne Shtojcen Nr.8 "Kriteret e Vecanta te kualifikimit" seksioni 3.3 "Kapaciteti teknik" pika 1 ne dokumentet e tenderit ku percaktohet: "Operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per sherbimet e meparshme te ngjashme te kryera gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e zhvillimit te procedures, ne vleren jo me pak se 40% e vleres*

*se fondit limit. Keto sherbime te meparshme, te ngjashme, duhet te vertetohen me dokumentacionin si me poshte: a)Kë sherbimet e ngjashme jane realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet te paraqese vertetimin e leshuar nga institucioni shteteror ose faturat tatimore ku te shenohen datat, shumat dhe sasite e sherbimeve te kryera. b)Kur sherbimet e ngjashme jane realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet te paraqese faturen perkatese tatimore te shitjes ku te shenohen datat, shumat dhe sasite e sherbimeve te kryera ... "*

*Me pretendimin si vijon: [ ... ] " .... Rezulton se shoqeria "Alpen Pulito" shpk nuk e ploteson kete kriter pasi ajo nuk ploteson xhiron ne kete vlere (tek xhiro e nje shoqerie futen edhe kontrata te tjera per sherbime jo si ky qe kerkohet ne proceduren e prokuruar) e jo me kontrata te meparshme te ngjashme me vlere sa 40% e vleres se fondit limit."*

*Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vleresimin e bere ne sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, dokumentet e dorezuara nga ofertuesi "Alpen Pulito" SHPK, pretendimet e parashtruara ne ankese mbi kualifikimin e ofertes se tij nga ofertuesi "Clean Fast" SHPK konstatoi se:*

*Per ofertuesin "Alpen Pulito" SHPK, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka njoftuar automatikisht nepermjet sistemit te prokurimit elektronik me date 19.05.2020, kualifikimin e tij.*

*Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionine paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga Ofertuesi "Alpen Pulito" SHPK dhe konstatoi:*

*Ne dokumentet e tenderit ne Shtojcen Nr.8 "Kriteret e Vecanta te kualifikimit" seksioni 3.3 "Kapaciteti teknik" pikat 1 percaktohet se operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per sherbimet e meparshme te ngjashme te kryera gjate 3 (tre) viteve te fundit nga data e zhvillimit te procedures, ne vleren jo me pak se 40% e vleres se fond it limit.*

*Nga verifikimi i sistemit te prokurimit elektronik rezulton se ofertuesi "Alpen Pulito" ne permbushje te kriterit te sipercituar te kete dorezuar fatura tatimore. Nga verifikimi rezulton se operatori ekonomik e permbush kriterin e sipercituar. Ne lidhje me pretendimin e ankimuesit se "shoqeria "Alpen Pulito" shpk nuk e ploteson kete, kriter pasi ajo nuk ploteson xhiron ne kete vlere (tek xhiro e nje shoqerie futen edhe kontrata te tjera per sherbime Jo si ky qe kerkohet ne proceduren e prokuruar) e jo me kontrata te meparshme te ngjashme me vlere sa 40% e vleres se fondit limit ", sqarojme se ne kriter percaktohet 3 (tre) vitet e fundit nga data e zhvillimit te procedures pra perfshihen periudha 2017, 2018, 2019.*

*Per arsyet e mesiperme pretendimi i ofertuesit "Clean Fast" SHPK nuk pranohet.*

*3.Ofertuesi "Clean Fast" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertuesit "Alpen Pulito" SHPK per mospermbushjen e kriterit ne Shtojcen Nr.8 "Kriteret e Vecanta te kualifikimit" seksioni 3.3 "Kapaciteti teknik" pika 2 ne dokumentet e tenderit ku percaktohet: "Operatori ekonomik duhet te kete jo me pak se 15 (pesembedhjete) punonjes ne fushen e pastrimit, te siguruar per periudhen Dhjetor 2019 - Shkurt 2020. Per te vertetuar kete pike, operatori ekonomik duhet te paraqese: Nje vertetim nga administrata tatimore per numrin mesatar te punonjesve per periudhen Dhjetor 2019 - Shkurt 2020; Listepagesat (E-Sig 025) te konfirmuara nga Administrata Tatimore per periudhen Dhjetor 2019 - Shkurt 2020; Kontratat e punesimit, librezat e punes dhe librezat shendetsore per te pakten 15 (pesembedhjete) punonjes ne fushen e pastrimit."*

*Me pretendimin si vijon: [ ... ] " .... Kapaciteti teknik, eshte kerkuar qe shoqeria te kete te pakten 15 punonjes te pajisur me librezat shendetesore ne fushen e pastrimit, kjo edhe ne kuader te Covid 19. Rezulton se shoqeria "Alpen Pulito" shpk nuk e ploteson kete kriter.*

*Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vleresimin e bere ne sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, dokumentet e dorezuara nga ofertuesi "Alpen Pulito" SHPK, pretendimet e parashtruara ne ankese mbi kualifikimin e ofertes se tij nga ofertuesi "Clean Fast" SHPK konstatoi se:*

*Per ofertuesin "Alpen Pulito" SHPK, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka njoftuar automatikisht nepermjet sistemit te prokurimit elektronik me date 19.05.2020, kualifikimin e tij.*

*Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga Ofertuesi "Alpen Pulito" SHPK dhe konstatoi:*

*Ne dokumentat e tenderit ne Shtojcen Nr.8 "Kriteret e Vecanta te kualifikimit" seksioni 3.3 "Kapaciteti teknik" pika 2 nder te tjera percaktohet se Operatori ekonomik duhet te kete jo me pak se 15 (pesernbedhjete) punonjes ne fushen e pastrimit, te siguruar per periudhen Dhjetor 2019 - Shkurt 2020. Per te vertetuar kete pike, operatori ekonomik duhet te paraqese: Nje vertetim nga administrata tatimore per numrin mesatar te punonjesve per periudhen Dhjetor 2019 - Shkurt 2020; Listepagesat (E-Sig 025) te konfirmuara nga Administrata Tatimore per periudhen Dhjetor 2019 - Shkurt 2020; Kontratat e punesimit, librezat e punes dhe librezat shendetsore per te pakten 15 (pesembedhjete) punonjes ne fushen e pastrimit.*

*Ne lidhje me pretendimin e ankimuesit se ne "kapaciteti teknik, eshte kerkuar qe shoqeria te kete te pakten 15 punonjes te pajisur me librezat shendetesore ne fushen e pastrimit, kjo edhe ne kuader te Covid 19. Rezulton se shoqeria "Alpen Pulito" shpk nuk e ploteson kete kriter", nga verifikimi i dokumentacionit te dorezuar ne sistemin e prokurimit elektronik nga ofertuesi "Alpen Pulito" ne permbushje te kriterit te percaktuar ne piken 2 te seksionit 3.3 "Kapaciteti teknik" ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" jane dorezuar dhe librezat e shendetesore.*

*Per arsyet e me siperme pretendimi i ofertuesit "Clean Fast" SHPK nuk pranohet.*

*4. Ofertuesi "Clean Fast" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertuesit "Alpen Pulito" SHPK per mospermbushjen e kriterit ne Shtojcen Nr.8 "Kriteret e Vecanta te kualifikimit" seksioni 3.3 "Kapaciteti teknik" pika 4 ne dokumentet e tenderit ku percaktohet: "Operatori ekonomik duhet te provoje se disponon: Kazane plehrash teknologjike (me mekanizem), minimuni 6(gjashte) cope. Kosha te vegjel mbeturinash per tu vendosur ne ane te rrugeve, minimuni 18 (tetembedhjete) cope; Karrela per pastrimin, minimuni 5 (pese) cope. Per te vertetuar kete pike, operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin qe verteton pronesine ose qiramarrjen si me poshte: Dokumentacioni qe verteton pronesine: kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose fatura shit-blerje ose cdo dokument tjeter me ane te se cilit fitohet e drejta e pronesise sipas Kodit Civil te Republikes se Shqiperise-Dokumentacioni qe verteton marrjen me qira: Kontrate qiraje."*

*Me pretendimin si vijon: [ ... ] " .... Ne piken 5 te kritereve te pergjithshme te pranimit/kualifikimit kiirkohet qe operatori ekonomik duhet te provoje se disponon: Kazane plehrash tcknologjike (me mekanizem), minimuni 6(gjashte) cope. Rezulton se shoqeria "Alpen Pulito" shpk nuk e ploteson kete kriter. "*

*Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vleresimin e bere ne sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, dokumentet e dorezuara nga ofertuesi "Alpen Pulito" SHPK, pretendimet e parashtruara ne ankese mbi kualifikimin e ofertes se tij nga ofertuesi "Clean Fast" SHPK konstatoi se:*

*Per ofertuesin "Alpen Pulito" SHPK, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka njoftuar automatikisht nepermjet sistemit te prokurimit elektronik me date 19.05.2020, kualifikimin e tij.*

*Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga Ofertuesi "Alpen Pulito" SHPK dhe konstatoi: Ne dokumentat e tenderit ne Shtojcen Nr.8 "Kriteret e Vecanta te kualifikimit" seksioni 3.3 "Kapaciteti teknik" pika 4 ne dokumentet e tenderit percaktohet se nder te tjera operatori ekonomik duhet te provoje se disponon Kazane plehrash teknologjike (me mekanizem), minimumi 6(gjashte) cope; Per te vertetuar kete pike, operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin qe verteton pronesine ose qiramarrjen si me poshte.-Dokumentacioni qe verteton pronesine: kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose fatura shit-blerje ose cdo dokument tjeter me ane te se cilit fitohet e drejta e pronesise sipas Kodit Civil te Republikes se Shqiperise-Dokumentacioni qe verteton marrjen me qira: Kontrate qiraje."*

*Nga verifikimi ne sistemin e prokurimit elektonik rezulton se ofertuesi "Alpen Pulito" shpk ka dorezuar fature tatimore shitja, si rrjedhim dokumentacioni i dorezuar permbush kriterin e percaktuar ne piken 4 ne seksionin 3.3 "Kapaciteti teknik" ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit" te dokumentave te tenderit.*

*Per arsyet e me siperme pretendimi i ofertuesit "Clean Fast" SHPK nuk pranohet.*

*5. Ofertuesi "Clean Fast" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertuesit "Alpen Pulito" SHPK per mospermbushjen e kriterit ne Shtojcen Nr.8 "Kriteret e Vecanta te kualifikimit" seksioni 3.1 ": "Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike" pikat 1 dhe 2 ne dokumentet e tenderit ku percaktohet: "1. Operatori ekonomik duhet te paraqese nje certifikate qe verteton cilesine e menaxhimit te shoqerise, sipas standardit nderkombetar ISO 9001 ose eikuivalent me te. Certifikata duhet te jete ne fuqi, e vlefshme ne diten e hapjes se procedures dhe te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise. 2. Operatori ekonomik duhet te paraqese nje certifikate qe verteton cilesine e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune, sipas standardit nderkombetar ISO 18001 ose ISO 45001 ose eikuivalent me te. Certifikata duhet te jete ne fuqi, e vlefshme ne diten e hapjes se procedures dhe te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise. Certifikatat te jene leshuara nga nje organ i vleresimit te korformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise. Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomike, sipas nenit 74 te VKM-914 date 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikata ISO sipas zerave te puneve/mallrave/sherbimeve qe do te marr persiper te realizoj sipas aktmarreveshjes. "*

*Me pretendimin si vijon: [...] " .... Ofertuesi "Alpen Pulito" shpk, nuk ploteson kriterin per dorezimin e certifikatave ISO 9001-2008/ISO 9001 -2015; ISO 18001;2007; ISO*

*14001:2004/ ISO 14001:2015, pasi certifikatat nuk jane leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura ne Republiken e Shqiperise."*

*Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vleresimin e bere ne sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, dokumentet e dorezuara nga ofertuesi "Alpen Pulito" SHPK, pretendimet e parashtruara ne ankese mbi kualifikimin e ofertes se tij nga ofertuesi "Clean Fast" SHPK konstatoi se:*

*Per ofertuesin "Alpen Pulito" SHPK, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka njoftuar automatikisht nepermjet sistemit te prokurimit elektronik me date 19.05.2020, kualifikimin e tij.*

*Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga Ofertuesi "Alpen Pulito" SHPK dhe konstatoi: Ne dokumentat e tenderit ne Shtojcen Nr.8 "Kriteret e Vecanta te kualifikimit" seksioni 3.1 "Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonomike" pikat 1 dhe 2 percaktohet se: Operatori ekonomik duhet te paraqese nje certifikate qe verteton cilesine e menaxhimit te shoqerise, sipas standardit nderkombetar ISO 9001 ose eikuivalent me te. Certifikata duhet te jete ne fuqi, e vlefshme ne diten e hapjes se procedures dhe te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise dhe nje certifikate qe verteton cilesine e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune, sipas standardit nderkombetar ISO 18001 ose ISO 45001 ose eikuivalent me te. Certifikata duhet te jete ne fuqi, e vlefshme ne diten e hapjes se procedures dhe te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise.*

*Nga verifikimi ne sistemin e prokurimit elektronik rezulton se ne permbushje te kriterit te sipercituar ofertuesi "Alpen Pulito" ka dorezuar certifikatat ISO 9001:2015 certifikimi i sistemit te menaxhimit te cilesise; 1SO 14001 ;2015 certifikimi i sistemit te menaxhimit te mjedisit; OHSAS 18001 :2007 certifikimi i sitemit per menaxhimin e sigurise dhe shendetit ne pune. Nga verifikimi rezulton se ISO-te e dorezuara permbushin kriteret e percaktuara ne pikat I dhe 2 ne seksionin 3.1 "Kapaciteti ligjor/profesional i operatoreve ekonornike" ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikimit".*

*Per arsyet e mesiperme pretendimi i ofertuesit "Clean Fast" SHPK nuk pranohet.*

*6. Ofertuesi "Clean Fast" SHPK ka ankimuar kualifikimin e ofertuesit "Alpen Pulito" SHPK me pretendimin si vijon: [ ... ] " .... Oferta e paraqitur nga o.fertuesi "Alpen Pulito "shpk, eshte oferte anomalisht e ulet. Oferta e paraqitur nga ofertuesi "Al pen Pulito "shpk, eshte oferte anornalisht e ulet dhe si e tille duhej skualifikuar. Konkretisht: Mesatarja e Ofertave te vlefshme eshte: Mo= 63.551.520,16*

*Pra, Zbritja e Mundshme eshte: ZM = 54.018.791,85*

*Pra Zbritja e Mundshme eshte 54.018.791,85 nderkohe qe oferta e paraqitur nga operatori ekonomik shoqeria "Alpen Pulito" shpk eshte 47.283.333 leke, pra me e vogel se Zbritja e Mundshme me nje diference prej 6.735.461,85 nga Zbritja e Mundshme, rrjedhimisht eshte nje oferte anomalisht e ulet dhe si e tille duhet skualifikuar.*

*Sipas nenit 56 te Ligjit per Prokurimet Publike kur autoriteti kontraktor veren se nje oferte eshte anomalisht e ulet, ai, perpara se te vazhdoje me procesin e vleresimit te ofertave, i kerkon operatorit ekonomik perkates te paraqese me shkrim dhe brenda 3 diteve pune shpjegime per elemente te vecanta te ofertes, per:*
*a) anen ekonomike te metodes se sherbirneve te ofruara;*
*b) zgjidhjet teknike te ofruara dhe/ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshern, qe ka ofertuesi per kryerjen e sherbimeve;*
*c) origjinalitetin e sherbimeve, te propozuara nga ofertuesi;*
*9) zbatueshmerine e detyrimeve, qe lidhen me mbrojtjen nc pune dhe kushtet e punes, ne vendin ku do te kryhet puna, sherbirni apo ku do te sigurohet furnizimi.*
*Pra ne kete rast duhet qe enti prokurues ti kerkoje shoqerise "Alpen Pulito" shpk, shpjegime per elementet e ofertes se paraqitur ne 5 drejtimet e permendura me siper. Enti prokurues duhet te kete parasysh shtojcen 8, Kriteret e vecanta te kualifikimit, pika 3.3 kapaciteti teknik, kerkohet qe ky sherbim te ofrohet minimalisht nga 15 punonj es pastrimi duke pasur parasysh se sherbimi i pastrimit ne spital eshte nje sherbim ku punonjesit nuk mund te paguhen me page minimale, duhet te mbahet parasysh qe paga minimale cdo vit percaktohet nga Keshilli i Ministrave me trend rrites. Duhet te kete parasysh shtojcen 9 qe sherbimi i pastrimit te kryhet me 3 turne, cfare do te thote se pastrimi do te kryhet 24 ore me tre turne ne 7 dite te javes. Kjo dote thote se do te kryhet sherbimi i pastrimit edhe ne intervalin orar nga ora 19.00 deri ne oren 6 te mengjesit. Ne nenin 81 te Kodit te Punes parashikohet se:*
*"1. Cdo ore pune e kryer nga ora 19. 00 deri ne 22. 00jep te drejten e nje shtese mbi page jo me pak se 20 per qind.*
*2. Cdo ore pune e kryer midis intervalit 22. 00 dhe 6. 00jep te drejten e nje shtese mbi page jo me pak se 50 per qind".*
*Pra eshte detyrim ligjor qe punonjesit qe do te punojne ne turnin e dyte dhe te trete te paguhen respektivisht me shtese page 20% dhe 50%, cka rrit zerin e shpenzimeve per paga. Po keshtu sherbimi i pastrimit ofrohet 24 ore ne 7 dite te javes, nderkohe qe po sipas Kodit te Punes (nenit 83) kohezgjatja normale e javes se punes eshte 40 ore, ndersa sipas nenit 85 te Kodit te Punes cdo punonjes ka te drejten ligjore te nje dite pushim ne jave, cka ben te domosdoshme pasjen e nje stafi shtese mbi numrin 15 te kerkuar nga enti prokurues per te zevendesuar punonjesit qe bejne pushimin javor, dhe kjo perkthehet ne kosto shtese te zerit te pagave te punonjesve.*
*Po keshtu sikurse u tha me larte, sherbimi i pastrimit ofrohet 24 ore ne 7 dite te javes, nderkohe qe sipas nenit 87 Kodit te Punes punonjesit qe punojne ne diten e pushimit zyrtar apo diten e diel perfitojne nje kompensim ne page jo me pak se 25 %, cka perkthehet ne kosto shtese te zerit te pagave.*
*Por per realizimin e sherbimit te pastrimit nuk kerkohet vetem fuqi punetore, por kerkohen edhe materiale pastrimi, makineri te specializuara per fshirjen e rrugeve, autobot uji per larjen e rrugeve nga muaji prill ne shtator, makine tekonologjike per heqjen e mbeturinave nje here apo dy here ne dite, grup i specializuar per pastrimet gjenerale nje here ne muaj, veshje te vecanta per punonjesit e pastrimit duke filluar nga kepuces e gomes, dorashkat etj,*

*Ne perfundim ne i theksojme entit prokurues se Shoqeria "Alpen Pulito" shpk nuk ka asnje avantazh ne anen ekonomike te metodes se sherbimeve te ofruara, nuk ka asnje zgjidhje teknike ose kusht favorizues te jashtezakonshem per kryerjen e sherbirneve, nuk ka asnje origjinalitet sherbimi, dhe ajo nuk mund ti shmanget zbatueshmerise se detyrimeve, qe lidhen me Kodin e Punes, qe te mund te justifikoje oferten anomalisht te ulet. Per kete kerkojme skualifikimin e ofertes se paraqitur nga shoqeria "Alpen Pulito" shpk dhe shpalljen fitues ne kete procedure prokurimi te Shoqerise "Clean Fast" shpk.*

*Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vleresimin e here ne sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, dokumentet e dorezuara nga ofertuesi "Alpen Pulito" SHPK, pretendirnet e parashtruara ne ankese mbi kualifikimin e ofertes se tij nga ofertuesi "Clean Fast" SHPK konstatoi se:*

*Per ofertuesin "Alpen Pulito" SHPK, Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka njoftuar automatikisht nepermjet sistemit te prokurimit elektronik me date 19.05.2020, kualifikimin e tij.*

*Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga Ofertuesi "Alpen Pulito" SHPK dhe konstatoi: [...] Nga shqyrtimi i ofertes ekonomike te ofertuesit "Alpen Pulito" SHPK, oferta ekonomike e paraqitur, ne zbatim te nenit 66 pika 5 te VKM nr.914 dale 29.12.2014 per "Mirutimin e Rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuai, rezulton anomalisht e ulet.*

*Ne pikat 1 dhe 2 te nenit 56 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikon se : "I. Kur autoriteti kontraktor veren se nje ose me shume oferta per kontratat e mallrave, puneve apo sherbimeve jane anomalisht te uleta, ai, perpara se te vazhdoje me procesin e vleresimit te ofertave, i kerkon operatorit ekonomik perkates te paraqese me shkrim dhe brenda 3 diteve pune shpjegime per elemente te vecanta te ofertes, per: a) anen ekonomike te metodes se ndertimit, procesit te prodhimit ose te sherbimeve te ofruara; b) zgjidhjet teknike te ofruara dhe/ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshem, qe ka ofertuesi per kryerjen e punimeve, per furnizimin e mallrave apo te sherbimeve; c) origjinalitetin e puneve, mallrave apo te sherbimeve, te propozuara nga ofertuesi; ç) zbatueshmerine e detyrimeve, qe lidhen me mbrojtjen ne pune dhe kushtet e punes, ne vendin ku do te kryhet puna, sherbimi apo ku do te sigurohet furnizimi. "; "2. Autoriteti kontraktor i verifikon keto elemente duke u keshilluar me ofertuesin dhe ne baze te informacionit te paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzoje oferten, kur edhe pas shqyrtimit te informacionit te paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo eshte e rregullt ne te gjitha elementet e saj"...*

*Ne zbatim te nenit te sipercituar ne daten 12.05.2020 Komisioni i Vleresimit te Ofertave, me ane te shkreses nr.758 prot me objekt "Kerkese per informacion mbi oferten anomalisht te ulet ", i ka kerkuar ofertuesit "Alpen Pulito" SHPK sqarim per oferten ekonomike me vlere 47,283,330 leke (pa TVSH) per proceduren e prokurimit "Sherbim i pastrimit te ambienteve te brendshme dhe te jashtme te Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali ", Vlore.”*

*Komisioni i Vleresimit te Ofertave ka kerkuar sqarimet si me poshte vijon: Oferta juaj e paraqitur eshte anomalisht e ulet sepse eshte zbritur me shume se 25 % e fondit limit te perllogaritur. Me qellim qe oferta juaj te konsiderohet dhe te kualifikohet bazuar ne nenin 56 te LPP kerkojme nga ana e shoqerise suaj te paraqisni detaje te metejshme me shkrim ne*

*lidhje me oferten duke perfshire elemente te cmimit dhe perllogaritjet e detajuara. Autoriteti kontraktor do te marre ne konsiderate sqarime si me poshte: - Aspektet ekonomike te procesit te fabrikimit/realizimit - zgjidhjet teknike te ofruara dhe/ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshem, qe ka ofertuesi per kryerjen e punimeve, per furnizimin e mallrave apo te sherbimeve; - origjinalitetin e puneve, mallrave apo te sherbimeve, te propozuara nga ofertuesi; - zbatueshmerine e detyrimeve, qe lidhen me mbrojtjen ne pune dhe kushtet e punes, ne vendin ku do te kryhet puna, sherbimi apo ku do te sigurohet furnizimi.*
*Ne daten 15.05.2020 ne sistemin elektronik te prokurimit, ofertuesi "Alpert Pulito" shpk brenda afatit kohor te percaktuar, ka argumentuar oferten anomalisht te ulet.*
*Nga shqyrtimi i dokumentacionit te dorezuar nga ana e ofertuesit rezulton se ne permbushje te parashikimeve te nenit 56 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar, jane dorezuar pershkrime narrative si edhe dokumentacion shoqerues dhe provues mbi argumentimin ligjor, teknik dhe ekonomik te ofertes se dorezuar ne Sistemin e Prokurimeve Elektronike, per proceduren e prokurimit objekt "Sherbim i pastrimit te ambienteve te brendshme dhe te jashtme te Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali", Vlore.*
*Konkretisht, ne lidhje me parashikimet e nenit 56 pika 1, te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik", i ndryshuar, ofertuesi "Alpen Pulito" ka dorezuar tabela argumentuese per shpenzimet ne lidhje me sherbimin e pastrimit per ambiente te brendshme, fshirjen manuale te rrugeve, per larje dhe mirembajten e rrugeve. Ne analizen e bere ofertuesi ka pasqyruar shpenzimet per punetoret, pagesen e sigurimeve shoqerore, shpenzimet e makinerive per larje, mjete pajisje, shpenzime administrative, fatura tatimore furnizimi etj.*
*Sa me siper eshte gjykuar se me ane te dokumentacionit te dorezuar ofertuesi "Alpen Pulito" SHPK permbush kater kushtet kumulative te kerkuara nga ligji i posacem ne drejtim te argumentimit te ofertes ekonomike anomalisht te ulet.*
*Per arsyet e me siperrne pretendimi i ofertuesit "Clean Fast" SHPK nuk pranohet.*
*Sa me siper, ju bejme me dije se kunder vendimit te organit qendror bleres mund te behet ankim ne Komisionin e Prokurimit Publik, ne perputhje me nenin 63, pika 6, te LPP."*

II.4.2. Në datën 05.06.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor.

II.5. Në datën 26.05.2020, operatori ekonomik ankimues "Sori-Al" sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke pretenduar si vijon:

*" [...]*
*Shoqeria "SORl-AL" Sh.p.k pretendon se kualifikimi i operatoreve ekonomik "ALPEN PULITO", "CLEAN FAST", "REJ", "SANITARY CLEANING" dhe "PASTRIME SILVIO" eshte bere ne shkelje te Ligjit "Per Prokurimin Publik", te ndryshuar dhe Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik", te ndryshuar, duke qene se keto operatore kane mangesi dhe parregullsi dokumentacioni te domosdoshem per kualifikim si me poshte vijon:*
*(1) ALPEN PULITO*

*Bazuar ne informacionin qe mund te sigurojme permes aksesit online ne faqe zyrtare te institucioneve si dhe referuar kritereve te kerkuara nga autoriteti juaj kontraktor, ne lidhje me kete operator ekonomik shoqeria jone pretendon se.*

*1. Operatori ekonomik "Alpen Pulito" sh.p.k ka dhene informacion te rreme ne Deklaraten per paraqitje oferte te pavarur, sipas shtojces 1, kjo pasi z.A.Pashaj rezulton edhe si administrator (drejtues teknik) edhe ne shoqerine "Sanitary Cleaning" sh.p.k.*

*[...] Duke qene se z. Agim Pashaj rezulton ne pozicione drejtuese sine shoqerine "ALPEN PULITO" ashtu edhe ne shoqerine "SANITARY CLEANING", dyshimi se ofertat e paraqitura nga keta dy operatore ekonomike pjesmarres jane te varura nga njera-tjetra eshte legjitim.*

*Dhenia e informacionit te rreme se ofertat jane te pavarura, ne kundershtim me parashikimet e Ligjit Per Prokurimin Publik, perben shkak per skualifikim per te 2 Operatoret Ekonomik nga kjo procedure prokurimi.*

*2. Operatori Ekonomik "ALPEN PULITO" nuk ka vertetuar permes Vertimit te debise te dorezuar se ka shlyer detyrimet e maturuara te energjise elektrike te kontratave te energjise. Vertetimi i dorezuar nga ana e ketij operatori nuk konflrmon shlyerjen e detyrimeve ti! maturuara (konkretisht muaji Mars 2020, duke qene se procedura eshte zhvilluar me date 30.04.2020) sic; kerkohet ne kriterin e percaktuar ne shkronjen (e) te seksionit 2 Kriteret e Vecanta per Kualifikimit te DST.*

*3. Operatori Ekonomik "ALPEN PULITO" nuk ploteson kriterin e vecante te kualifikimit lidhur me kapacitetin ekonomik dhe financiar sipas kerkeses ne piken 3.2.1 "Kopje te deklaratave te xhiros vjetore ose vertetim nga administrata tatimore, per xhiron e realizuar ne vitet 2016,2017 dhe 2018, vlera mesatare e te ciles te jete jo me e vogel se 40% e vleres se fondit limit".*

*Vlera mesatare e xhiros per vitet 2016, 2017 dhe 2018 per Operatorin Ekonomik "ALPEN PULITO" eshte me e vogel se 40 % e fondit limit, pra me e vogel se 30,750,536lek (Tridhjete milion e shtateqind e pesedhjete mije e peseqind e tridhjete e gjashte lek).*

*4. Operatori Ekonomik "ALPEN PULITO" nuk ka dorezuar Vertetim per kontributet e sigurimeve shoqerore e shendetesore per te vertetuar numrin e punonjesve te punesuar gjate periudhen Shkurt 2020. Operatori rezulton te kete detyrime lidhur me pagesen e sigurimeve shoqerore dhe shendetsore per muajin shkurt 2020, edhe pse afati ligjor per mbylljen e detyrimeve sipas deklarimeve ne listpagese eshte brenda dates 20 te muajit shkurt, nderkohe qe procedura eshte zhvilluar me date 30 prill 2020.*

*Operatori rkonomik "Alpen Pulito" sh.p.k nuk ploteson numrin e te punesuarve te kerkuar ne fushen e pastrimit per priudhen e kerkuar, punonjesit e paraqitur nga ofertuesi kane mangesi ne dokumentacionin e paraqitur, pasi jo te gjithe figurojne te jene punonjes pastrimi.*

*5. Se fundi Operatori Ekonomik "ALPEN PULITO" ka dorezuar Oferte Anomalisht te Ulet. Ne piken 3.3.2 te DST-se parashikohet se: Oferta dote cilesohet anomalisht e ulet sipas percaktimit te bere ne nenin 66 te Kreut VII te RrPP .*

*Formula qe do te zbatohet per te cilesuar nje oferte anomalisht te ulet, ne rastin kur ka tre ose me shume oferta te vlefshme eshte si me poshte:*

*0- Oferta*

*Mo- Mesatarja e Ofertave te vlefshme n - Numri i Ofertave te vlefshme*

*ZM- Zbritja e Mundshme*

*Mo = 01 + 02 + 03 + ... On I n*

*ZM=85 %Mo*

*Viera e Ofertes qe vleresohet <ZM .......... , si rrjedhim Oferta eshte Anomalisht e Ulet*

*Oferta te vlefshme ne kete procedure prokurimi jane:*

*1.ALPEN PULITO me oferte 47,283,330.00 lek pa tvsh;*

*2. CLEAN FAST me oferte 59,103,548.00 lek pa tvsh;*

*3. REJ me oferte 59,219,330.00 lek pa tvsh;*

*4. SANITARY CLEANING me oferte 69,760,322.00 lek pa tvsh;*

*5. PASTRIME SILVIO me oferte 69,874,328.00 lek pa tvsh;*

*6. SORI-AL me oferte 76,068,263.00 lek pa tvsh.*

*Mo=47,283,330+59,103,548+59,219,330+69,760,322+69,874,328+76,068,263*

*381,309,121.00/6= 63,551,520.17 lek.*

*ZM = 85 % *63,551,520.17= 54,018,792.14 lek pa tvsh*

*Pra zbritja e mundshme eshte 54,018,792.14 lek pa tvsh, nderkohe qe Operatori Ekonomik "ALPEN PULITO" ka dorezuar oferte me zbritje me teper sesa zbritja e mundshme, ne vleren e 47,283,330 lek pa tvsh.*

*Ne neni 56 te LPP-se "Oferta anomalisht e ulet", ne piken 2, paragrafi i dyte parashokohet se: Autoriteti kontraktor mund ta refuzoje oferten, kur edhe pas shqyrtimit te infomacionit te paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo eshte e rregullt ne te gjitha elementet e saj.*

*Lidhur me pretendimet e ofertuesit "Sori-Al" SHPK ndaj vendimit per kualifikimin e ofertes se ofertuesve "Clean Fast" sh.p.k, "Rej" sh.p.k, "Sanitary Cleaning" sh.p.k, dhe "Pastrime Silvio" sh.p.k ne proceduren e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave gjykon se per sa kohe qe pretendimet e mesiperme nuk qendrojne, pasi ofertuesi "Alpen Pulito" SHPK permbush kriteret e kualifikimit per te cilat ngre pretendime ankimuesi dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit te Komisionit te Shqyrtimit te Ankesave do te mbetet e kualifikuar, trajtimi i pretendimeve te ankimuesit ne lidhje me kualifikimin e ofertuesit te tjere pjesernarres ne proceduren e prokurimit objekt shqyrtimi, nuk ka ndikim mbi fatin e ceshtjes, pasi bazuar ne legjislacionin ne fuqi per prokurimin publik, interesi i ligjshem i drejtperdrejte i ankimuesit, nuk ka sesi te demtohet nga suksesi apo deshtimi i operatoreve te tjere ne kete procedure prokurimi, pasi edhe ne hipotezen qe keto pretendime do te pranoheshin, ai serish nuk do te mund te shpallej fitues i kontrates objekt prokurimi, duke qene se ne renditjen perfundimtare, para tij qendron nje tjeter operator ekonomik i kualifikuar. Per kete arsye keto pretendime nuk do te merren ne shqyrtim.*

II.5.2. Në datën 08.06.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt si edhe në autoritetin kontraktor.

II.6. Në datën 17.06.2020 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 526/3 prot., informacioni e dokumentacioni i autoritetit kontraktor mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesave.

## III

## Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

**Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik " Clean Fast" sh.p.k se: "*Ne piken 3.2 te shtojces nr.8 te kritereve te pergjithshme te pranimit/kualifikimit te titulluar "Kapaciteti ekonomik*

*dhe financiar", kerkohet: “1.Kopje te deklaratave te xhiros vjetore ose vertetim nga administrata tatimore, per xhiron e realizuar ne vitet 2016, 2017 dhe 2018, vlera mesatare e te ciles te jete jo me e vogel se 40% e vleres se fondit limit. 2. Kopje te certifikuara te bilanceve te viteve: 2016, 2017, 2018, te paraqitura prane autoriteteve perkatese tatimore”. Operatori ekonomik shoqeria "Alpen Pulito" shpk, nuk i ploteson kushtet e mesiperme te percaktuara ne pikat 1 dhe 2. Konkretisht referuar deklarimeve te shoqerise "Alpen Pulito" shpk ne QKB rezulton se ajo ka nje xhiro te realizuar ne vitet 2016, 2017 dhe 2018, vlera mesatare e te ciles eshte me e vogel se 40% e vleres se fondit limit, nderkohe qe kerkohet qe kjo xhiro duhet te jete mbi 40% e vleres se fondit limit. Keshtu ne keto tre vite shoqeria "Alpen Pulito" shpk ka deklaruar xhirot e meposhtme: Viti 2016-Xhiro Vjetore 34.912.439; Viti 2017 - Xhiro Vjetore 25.867.759; Viti 2018-Xhiro Vjetore 30.203.428. Mesatarja e ketyre xhirove eshte 30.327.875 pra me e vogel se 40% e fondit limit pra e vleres 30.750.536,24*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 8 *“Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”*, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

1. “*Kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në vitet 2016,2017 dhe 2018, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit.”*

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Alpen Pulito” sh.p.k., për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon.

- Vërtetim Nr. T02056956, datë 15.04.2020, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durres, për Xhiron e tre viteve 2017, 2018, 2019 të subjektit “Alpen Pulito” sh.p.k.
- Vërtetim Nr. T01651708, datë 24.12.2019, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durres, për Xhiron e tre viteve 2016, 2017, 2018 të subjektit “Alpen Pulito” sh.p.k.

me të dhënat si vijon:

| | |
|---|---|
| Periudha Tatimore 19-A | 29.520.404 |
| Periudha Tatimore 18-A | 30.203.428 |
| Periudha Tatimore 17-A | 25.867.759 |
| Periudha Tatimore 16-A | 34.912.439 |

III.1.3. Në nenin 46, pika 1/c e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”,* i ndryshuar parashikohet se : *“[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevoje, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur.” [...]”*

III.1.4. Në nenin 28, pika 4 germat "a" dhe "b" të VKM Nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikohet se: *"Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse:dhe/ose b) "kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet;*

III.1.5. Nëpërmjet shkresës nr. 884/3 prot., datë 01.06.2020 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke sqaruar si vijon: " [...] *Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave, verifikoi ne sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjese e ofertes ekonomike nga Ofertuesi "Alpen Pulito" SHPK dhe konstatoi: Ne dokumentet e tenderit ne Shtojcen Nr.8 "Kriteret e Vecanta te kualifikimit" seksioni 3.2 "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" pikat 1 dhe 2, percaktohet se ofertuesi duhet te dorezoje, kopje te deklaratave te xhiros vjetore ose vertetim nga administrata tatimore, per xhiron e realizuar ne vitet 2016,2017 dhe 2018, vlera mesatare e te ciles te jete jo me e vogel se 40% e vleres se fond it limit si dhe kopje te certifikuara te bilanceve te viteve 2016, 2017, 2018, te paraqitura prane autoriteteve perkatese tatimore. Nga verifikimi i sistemit te prokurimit elektronik rezulton se ofertuesi ne permbushje te kritereve te sipercituara ka dorezuar dokumentacionin me emertim "Vertetim xhiro tre vitet e fundit", "Vertetim xhiro 2016" dhe "Bilancet". Pjese e ketij dokumentacioni eshte vertetimi nr. T02056956 date 15.04.2020 ku jane te pasqyruara vertetimet per xhiron e tre viteve te fundit 17-A, 18-A, 19-A; vertetimi nr. TO 1651708 date 24.12.2019 ku jane te pasqyruara vertetimet e xhiros per periudhen 16- A, 17-A dhe 18-A. Nga verifikimi i dokumentacionit te dorezuar ne permbushje te kriterit te percaktuar ne piken 1 ne seksion 3.2 "Kapaciteti ekonomik dhe financiar" ne "Kriteret e Vecanta te Kualifikirnit" rezulton se ofertuesi "Alpen Pulito" SHPK nuk e ka permbushur kriterin. Nga verifikimi i proces verbalit te mbajtur nga Komisioni i Vleresimit te ofertave rezulton se mos permbushja e ketij kriteri eshte cilesuar devijim i vogel. Sqarojme se:*

*[...]Ne piken 4 te nenit 53 te Ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", te ndryshuar, percaktohet se: "4.Autoriteti kontraktor vlereson nje oferte te vlefshme edhe nese ajo perrnban devijime te vogla, te argumentuara, te cilat nuk ndryshojne thelbesisht karakteristikat, kushtet dhe kerkesat e tjera, te percaktuara ne dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, te cilat mund te korrigjohen pa prekur perrnbajtjen e saj." Pra, komisioni i vleresimit te ofertave mund te konsideroje nje oferte te vlefshme edhe nese: a) ajo perrnban devijime te vogla, te cilat materialisht nuk ndryshojne ose devijojne kushtet dhe kerkesat e tjera, te percaktuara ne dokumentet e tenderit; b) oferta perrnban gabime apo lapsuse, te cilat mund te korrigjohen pa prekur permbajtjen e ofertes. Te gjitha devijimet e tilla dote mblidhen, sate jete e mundur dhe do t'u kushtohet vernendja e duhur ne vleresimin dhe ne krahasimin e ofertave. Ne kete kuptim, nocioni mbi ofertat qe perrnbajne devijime te vogla mund te konsiderohen si te pershtatshrne ne zbatim te LPP, neni 53, pika 4. Ky nocion, referuar ne praktike si "pershtatshmeri thelbesore" e ofertave ndaj kerkesave ne dokumentet e tenderit, bazohet ne dallimin mes "devijimeve te vogla" nga "devijimet rnateriale". Devijime te*

*vogla jane devijimet qe nuk ndryshojne materialisht ose nuk i kalojne specifikimet, kushtet, termat dhe kerkesat e tjera te parashtruara ne dokumentet e tenderit ose gabimet apo pakujdesite qe mund te korrigjohen pa ndryshuar thelbin e tenderit. Devijimet materiale jane devijime nga kriteret e identifikuara te cilat burojne nga kuadri ligjor rregullator (ligjet, aktet nenligjore dhe rregulloret, parimet e menaxhimit te shendoshe financiar ose te sjelljes se zyrtareve publike). Per sa kohe qe nje devijim nga kerkesat e specifikuara dhe specifikimet nuk do te thote trajtim i pabarabarte i ofertuesve dhe ka nje ndikim te paperfillshem ne konkurrencen e lire dhe te ndershme ne mes tyre dhe qe nuk ndikon ne procesin e zbatimit te kontrates, devijimi i tille nuk konsiderohet si "i konsiderueshem". Njesia matese e devijimeve eshte esenciale nese devijimi do ta bente te parnundur krahasimin e ofertave dhe per kete arsye do te ishte i pamundur vleresimi ne menyre te barabarte te ofertuesve. Refuzimi i ofertave me te ulta thjesht per devijime te vogla kufizon konkurrencen, demton ekonomine si dhe efikasitetin e mire perdorimit te fondeve publike.*

III.1.6. Sa më sipër, KPP gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik "Alpen Pulito" sh.p.k. konstatohet se ky i fundit ka paraqitur dy vërtetime të lëshuara nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës, në të cilin pasqyrohet xhiro e katër viteve të fundit 2016, 2017, 2018, 2019 si më sipër cituar. Nisur nga fondi limit i procedurës së prokurimit në masën 76,876,340.6 leke pa tvsh si dhe kërkesa e autoritetit kontraktor: "*Kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar në vitet 2016,2017 dhe 2018, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit",* rezulton se operatori ekonomik "Alpen Pulito" sh.p.k nuk plotëson kërkesën e autoritetit kontraktor për xhiron mesatare të tre viteve të fundit.
Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik "Clean Fast" sh.p.k., mbi kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik "Alpen Pulito" sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, referuar arsyetimit të mësipërm, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik "Alpen Pulito" sh.p.k do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, duke përmbushur kështu interesin e ankimuesit. Rrjedhimisht pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik "Alpen Pulito" sh.p.k. nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3. Lidhur me pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik “Sori-Al” sh.p.k., mbi kualifikimin e padrejtë të operatorit ekonomik “Alpen Pulito” sh.p.k., Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, referuar arsyetimit të mësipërm, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Alpen Pulito” sh.p.k do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, duke përmbushur kështu interesin e ankimuesit. Rrjedhimisht pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues për skualifikimin e operatorit ekonomik “Alpen Pulito” sh.p.k. nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.4. Lidhur me pretendimin e shoqërisë “Sori-Al” sh.p.k se: “*Referuar shtojces 8 “Kritere te pergjithshme te pranimit/kualifikimit te DST, kerkohet dorezimi i vetedeklarimit sipas permbajtjes se shtojces 7 “Kriteret e Pergjithshme te pranimit/kualifikimit" e cila kerkon qe: "Operatori Ekonomik duhet te vetedeklaroje per ... Personi/at ne cilesine e anetarit te organit administrativ, drejtuesit ose mbikeqyresit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca perfaqesuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik. .. ". Bazuar ne Ekstraktin e Regjistrit Tregtar te Operatorit Ekonomik "CLEAN FAST" rezulton qe ortaku i vetem dhe administrator eshte Znj. Eriola Likaj, ndersa si Ekspert Kontabel rezulton Shoqeria "SAO ADVISORS" Sh.p.k. Plotesimi i kesaj shtojce nuk eshte bere konform kerkesave te Ligjit per Prokurimin Publik, pasi nuk jane plotesuar te dhenat e kerkuara ne kete shotjce per Ekspertin Kontabel "SAO ADVISORS" Sh.p.k, i cili ka kompetenca kontrolluese ne kete operator ekonomik, dhe duke qene se eshte person juridik duhet te shenohen te dhenat e ortakeve/administratoreve te tij [...]”,* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 7 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë :

***Shtojca 7***

**[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]**

*DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME*

*Deklaratë e operatorit ekonomik pjesemarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë_______________ nga Autoriteti Kontraktor ___________ me objekt ____________________me fond limit __________.*

*Unë i nënshkruari ___________________me cilesinë ___________të operatorit ekonomik ____________________ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:*

- *Operatori ekonomik ______________________ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.*
- *Operatori ekonomik ____________________ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.*
- *Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:*

| | Emër (Emrat) | Mbiemër | Datëlindje ditë muaj vit | Atësi | Amësi | Vendlindje |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | | | | | |
| 2 | | | | | | |
| 3 | | | | | | |

*nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP[1].*

- *Operatori ekonomik ____________________ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.*
- *Operatori ekonomik ____________________ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).*
- *Operatori ekonomik ____________________ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.*

*Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.*
*Data e dorëzimit të deklaratës _____________*
*Nënshkrimi i ofertuesit ______________*
*Vula ______________*

III.4.2. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik ankimues "Clean Fast" shpk në përmbushje të shtojcës sa më sipër ka dorëzuar deklaratën me përmbajtje si më poshtë:

*"Unë i nënshkruari E.L me cilesinë e administratorit të operatorit* ekonomik Clean Fast *shpk deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:*

- *Operatori ekonomik Clean Fast shpk është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".*

- *Operatori ekonomik Clean Fast nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.*

- *Personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:*

*EL*
*EG*

*nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP.*

- *Operatori ekonomik Clean Fast shpk nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.*

- *Operatori ekonomik Clean Fast shpk nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).*
- *Operatori ekonomik Clean Fast shpk ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.*

Në fund të kësaj shtojce është deklaruar se:
*"Në cdo rast autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.*

III.4.3. Në nenin 46, pika 1, gërma "b", të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: "*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese*.
Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet: "*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...".*

III.4.4. Referuar ekstraktit të regjistrit tregëtar të subjektit Clean Fast rezulton se kjo shoqëri në cilësinë e administratorit ka caktuar EL si dhe në cilësinë e ortakëve të shoqërisë shfaqet përsëri EL.

III.4.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik "Clean Fast" shpk ka dorëzuar shtojcën 7 *"*Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme" si më sipër pasqyruar, nga ku rezulton se ka deklaruar administratorin e shoqërisë dhe ortakun e saj. Kjo deklaratë është plotësuar në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të parashikuara në shtojcën 7 të dokumentave të tenderit dhe përmban të gjithë informacionin e kërkuar në këtë shtojcë.

III.4.6. Në Ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "*Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratur",* i ndryshuar, neni 2, pika 1, përcakton se:
*"Auditim ligjor" është një auditim i pavarur i pasqyrave financiare vjetore, individuale dhe/ose të konsoliduara, nëse: a) kërkohet nga ky ligj; b) kërkohet nga ligje të tjera; c) kryhet në mënyrë vullnetare, me kërkesë të ortakëve/aksionarëve të njësive ekonomike të biznesit ose nga palë të tjera të interesuara, kur për auditimin ligjor zbatohen standarde dhe kërkesa të legjislacionit, të barasvlershme me ato që kërkohen për një auditim ligjor, sipas shkronjës "a" të kësaj pike." Ndërsa në pikën 7 po këtu, thuhet: "Auditues ligjor" është individi i miratuar nga autoritetet kompetente për të kryer auditime ligjore, si dhe i regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjorë dhe shoqërive të auditimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji*".

Neni 43, i këtij ligji, përcakton se:
"*Në rastin e auditimit ligjor të pasqyrave financiare të konsoliduara të një grupi sipërmarrjesh, audituesi ligjor i grupit: a) mban përgjegjësi të plotë për auditimin e pasqyrave financiare të konsoliduara dhe raportin e auditimit; b) kryen kontroll të auditimit, të bërë nga audituesit ligjorë të tjerë, si edhe në një juridiksion tjetër, për qëllimet e auditimit të grupit.*"

III.4.7. Operatorët ekonomikë kanë detyrimin ligjor të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Pra autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014, i ndryshuar.

III.4.8. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se shoqëria "Clean Fast" shpk nuk ndodhet në kushtet e parashikuara në nënin 45, pika 1 të LPP-së pasi audituesi nuk është individ me detyra kontrolluese brenda subjektit dhe nuk ka funksione brenda shoqërisë. Funksionet e tij janë të kufizuara përsa i përket bilanceve të cilat përgatiten nga vetë shoqëria për palët e treta, ndërkohë që audituesi kryen auditimin e pavarur të pasqyrave financiare vjetore. Ai është subjekt i miratuar nga autoritetet kompetente për të kryer auditime ligjore, si dhe i regjistruar në regjistrin publik të audituesve ligjore dhe shoqërive të auditimit, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Në përputhje me nenin 24, pika 1 të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "*Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratura*", i ndryshuar, *"E drejta për ushtrimin e veprimtarisë si shoqëri audituese hiqet nga bordi, në rastet kur shkelen kushtet dhe/ose kur ndryshojnë rrethanat e parashikuara në këtë ligj, të cilat konsiderohen të domosdoshme për autorizimin e regjistrimit".*

Pra operatorët ekonomikë nuk kanë asnjë detyrim ligjor, në përputhje me nenin 45 të LPP-së, të deklarojnë në procedurat e prokurimit audituesit e tyre ligjorë, në kushtet kur këta nuk janë në përbërje të shoqërisë dhe për aktivitetin e tyre përgjigjen pranë organeve të parashikuara në ligjin përkatës si më sipërcituar.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit "Sori-Al"shpk nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e shoqërisë "Sori-Al" sh.p.k se: " *Operatori Ekonomik "CLEAN FAST" ka dorezuar oferte ekonomike me gabime. Gabimet ne llogaritjen e cmimit do te korrigjohen nga Autoriteti Kontraktor, si me poshte:*
*- nese ka mosperputhje ndermjet cmimit njesi dhe vleres se pergjithshme qe merret nga shumezimi i cmimit njesi dhe sasise, atehere do te mbizoteroje cmimi njesi, dhe rrjedhimisht duhet te korrigjohet shuma ne total, nese ka nje gabim ne nje shume total, qe korrespondon me mbledhjen ose zbritjen e nentotaleve, atehere do te mbizoteroje nentotali dhe totali duhet te korrigjohet. Shumat e korrigjuara ne kete menyre jane te detyrueshme per ofertuesin. Nese ofertuesi nuk i pranon ato, atehere oferta e tij do te refuzohet. Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute te te gjitha korrigjimeve jane me shume se ± 2 % e vleres se ofertes ekonomike te ofruar",* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" parashikohet shprehimisht se: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese."*

III.5.2.Në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.*”

III.5.3. Në nenin 53/2 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “*Autoriteti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave, me kusht që këto të mos jenë bërë për qëllime mashtrimi. Autoriteti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën”.*

III.5.4. Në rastin konkret, nga verifikimi i Formularit të Ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Clean Fast” sh.p.k, konstatohet se paraqitja dhe plotësimi i zërave të tij është bërë konform kërkesave të publikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Në dokumentat standartet të tenderit, është e përcaktuar në seksionin II Udhëzime për operatorët ekonomikë pika 1.6. *“Oferta duhet të përfshijë dokumentat e mëposhtëm: a) Formularin e Ofertës plotësuar sipas Shtojcës 1. [...]”.* Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi përllogaritjet e bëra nga operatori ekonomik “Clean Fast” sh.p.k dhe konstatoi se ato nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ndaj dhe korrigjimi i ofertës, në zbatim të nenit 53/2 të ligjit të mësipërm nuk është i nevojshëm.

Pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e shoqërisë “Sori-Al” sh.p.k se: *Operatori ekonomik “Clean Fast” sh.p.k nuk ploteson kriterin per dorezimin e certifikates ISO 18001 ose ekuivalentin e saj ISO 45001, e cila duhet te jete leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetar akreditues te njohura nga Republika e Shqiperise dhe per me teper nuk jane te legalizuara apo me vule apostile si dhe duhet te perputhet kodi i certifikates me objektin e veprimtarise se procedures se prokurimit”,* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën 8 *« Kriteret e vecanta të kualifikimit », “Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë»,* të dokumentave të tenderit, rezulton se nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

1. *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë një çertifikatë qe vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqerisë, sipas standardardit ndërkombëtar ISO 9001 ose eikuivalent me të. Çertifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.*
2. *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një çertifikatë qe vërteton cilesine e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune, sipas standardardit ndërkombëtar ISO 18001 ose ISO 45001 ose eikuivalent me të. Çertifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.*

*Çertifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*
*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 te VKM-914 date 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certefikata ISO sipas zërave te punëve/mallrave/shërbimeve qe do te marr përsipër te realizoj sipas aktmarrëveshjes.*

III.6.2. Për plotësimin e kriterit të mësipërm, lidhur me certifikatën qe vërteton cilesine e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune, sipas standardardit ndërkombëtar ISO 18001 ose ISO 45001 ose eikuivalent me të, operatori ekonomik "Clean Fast" sh.p.k ka paraqitur dokumentacionin si vijon:

1. Certifikatë ISO 45001:2018 "*Certifikimi i sistemit për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit në punë",* lëshuar nga kompania King Cert në emër të shoqërisë "Clean Fast" sh.p.k, në fushat e mëposhme: *"Shërbimi i pastrimit dhe higjenës së ambienteve të brendshme, ndërtesave civile e industrial dhe hapësirave publike. Pastrimi dhe mirëmbajtja e mjediseve të jashme. Shërbime të dezinfekstimit, deratizimit dhe desinsektimit.",* me datë mbarimi te cert. 04.02.2021 dhe datë përfundimtare cert: 04.02.2023.

III.6.3. Në nenin 46 "*Kualifikimi i ofertuesve*", pika 1 dhe 2 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, parashikohet se *" [...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:*

*Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit.. […]"*
Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: "*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..."*

III.6.4. Në nenin 30 "*Kërkesat e cilësisë*" të VKM Nr.914 datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar parashikohet se:

1. *Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*
   *Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.*
2. *Çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit".*

III.6.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kritereve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të

vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kapaciteteve të kërkuara në dokumentat e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor, do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit në respekt të nenit 66 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 i ndryshuar. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën ekonomike në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.6.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike të dorëzuar nga shoqëria "*Clean Fast*" sh.p.k, si dhe nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, KPP konstaton se në përmbushje të kriterit "*Operatori ekonomik duhet të paraqesë një çertifikatë qe vërteton cilesine e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune, sipas standardardit ndërkombëtar ISO 18001 ose ISO 45001 ose eikuivalent me të. Çertifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë",* të procedurës së prokurimit objekt ankimi, operatori ekonomik "*Clean Fast*" sh.p.k, ka paraqitur Certifikatë ISO 45001:2018 "*Certifikimi i sistemit për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit në punë",* lëshuar nga kompania King Cert në emër të shoqërisë "Clean Fast" sh.p.k, në fushat e mëposhme: *"Shërbimi i pastrimit dhe higjenës së ambienteve të brendshme, ndërtesave civile e industrial dhe hapësirave publike. Pastrimi dhe mirëmbajtja e mjediseve të jashme. Shërbime të dezinfekstimit, deratizimit dhe desinsektimit.",* me datë mbarimi te cert. 04.02.2021 dhe datë përfundimtare cert: 04.02.2023. Pas një verifikimi të kryer në internet, rezulton se kompania KING CERT e cila ka certifikuar shoqërinë "*Clean Fast*" sh.p.k për sistemin e menaxhimit ISO 45001:2018 "*Certifikimi i sistemit për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit në punë*", në fushat: "*Shërbimi i pastrimit dhe higjenës së ambienteve të brendshme, ndërtesave civile e industrial dhe hapësirave publike. Pastrimi dhe mirëmbajtja e mjediseve të jashme. Shërbime të dezinfekstimit, deratizimit dhe desinsektimit*", rezulton e akredituar nga kompania IAS Accredited Management Systems Certification Body

MSCB-196 e cila është anëtare e Forumit Ndërkombëtar të Akreditimit (IAF), anëtare e të cilit është dhe DPA.

Përsa i përket pretendimit të ankimuesit se *"nuk jane te legalizuara apo me vule apostile si dhe duhet te perputhet kodi i certifikates me objektin e veprimtarise se procedures se prokurimit*, rezulton se autoriteti kontraktor nuk i ka parashikuar në dokumentat e tenderit këto kërkesa, gjë e cila do të përbënte detyrim për tu përmbushur nga operatorët ekonomikë nëse do të kërkoheshin në DT.

Në nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet *2.Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.*

Ndërsa në nenin 28, pika 2 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" i ndryshuar, përcaktohet se: "*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve"*

Në mënyrë eksplicide ligji për prokurimin publik parashikon se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kritereve të tjera të kualifikimit të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm që është në kundërshtim me nenin 55 pika 2 e LPP-së, si më sipër cituar, por cënon gjithashtu parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 2 i *lex specialis*, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve.

Përsa më sipër pretendimet e ankimuesit nuk qëndrojnë.

III.7. Lidhur me pretendimin e shoqërisë "Sori-Al" sh.p.k se: "*Operatori Ekonomik "CLEAN FAST" ka deshtuar ne dorezimin e plote ligjor per te vertetuar se disponon kazane plehrash teknologjike (me mekanizem) sipas gjithe kerkesave te nenpikes 4, te pikes 3.3 "Kapaciteti teknik" te DST-se. Eshte detyrim i Operatorit Ekonomik qe ne cdo rast, qofte permes faturat tatimore te shitjes apo permes kontratave te qerase te detajoje dhe saktesoje llojin e pajisjes, e cila duhet te jete konform kerkesave specifike te DST-se, pra kazane plehrash teknologiike (me mekanizem). Mungesa e ketyre elementeve thelbesore ne dokumentacionin e paraqitur nga Shoqeria "CLEAN FAST" duhet t'i mjaftonte Komisionit te Vleresimit te Ofertave per skualifikmin e ketij operatori",* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.7.1. Në shtojcën 8 *« Kriteret e vecanta të kualifikimit », "Kapaciteti teknik i operatorëve ekonomikë»*, pika 4, të dokumentave të tenderit, rezulton se nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

*"Operatori ekonomik duhet te provojë se disponon:*

- *Kazanë plehrash teknologjike (me mekanizëm), minimuni 6(gjashtë) copë;*

- *Kosha të vegjel mbeturinash për tu vendosur në anë të rrugëve, minimumi 18(tetëmbëdhjetë) copë;*
- *Karrela për pastrimin, minimumi 5(pesë) copë.*

*Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin që vërteton pronësinë ose qiramarrjen si më poshtë:*

- ***Dokumentacioni qe vërteton pronësinë:** kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose fatura shit-blerje ose çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.*
- ***Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:** Kontratë qiraje."*

III.7.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik "Clean Fast" sh.p.k, rezulton se, për plotësimin e kërkesës së autoritetit kontraktor për *Kazanë plehrash teknologjike (me mekanizëm), minimumi 6(gjashtë) copë,* objekt ankimimi, është paraqitur si vijon:

- Kontratë qiraje nr.788 rep dhe nr.318 kol, datë 23.04.2020, për marrjen me qera të koshave plehrash teknologjike me mekanizëm, 7 (shtatë) copë, ndërmjet qeradhënësit shoqërisë "Korsel" sh.p.k. dhe qeramarrësit shoqëria "Clean Fast" sh.p.k.

- Faturë tatimore shitje nr.72, datë 30.05.2018 me blerës shoqërinë "Korsel" sh.p.k

III.7.3. Në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;"*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: "*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..."*

III.7.4. Në nenin 28, pika 5/ç të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar parashikohet se *"Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën."*

III.7.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.7.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “Clean Fast” sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se nga ana e tij janë dorëzuar Kontratë qiraje për marrjen me qira të 7 (shtatë) copë koshave plehrash teknologjike me mekanizëm nga shoqëria “Korsel” sh.p.k, si dhe faturë tatimore shitje, me blerës shoqërinë “Korsel” sh.p.k të cilat, në përputhje me kriterin e kualifikimit për disponimin e makinerive dhe pajisjeve të mësipërme sipas të cilit disponimin e tyre operatori pjesmarrës duhet ta vërtetojë nëpërmjet dokumentacionit të *pronësinë ose qiramarrjen si vijon:* ***Dokumentacioni qe vërteton pronësinë:*** *kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose fatura shit-blerje ose çdo dokument tjetër me anë të së cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë;* ***Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*** *Kontratë qiraje*.

III.7.7. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit.
Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Clean Fast” sh.p.k është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Rrjedhimisht, sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.8. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “Sori-Al” sh.p.k ndaj vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertave të operatorëve ekonomikë “Rej” sh.p.k, “Sanitary Cleaning” sh.p.k dhe “Pastrime Silvio” sh.p.k në procedurën e prokurimit objekt shyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë, pasi operatori ekonomik “Clean Fast” sh.p.k përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P do të mbetet e kualifikuar, trajtimi i pretendimeve të ankimuesit në lidhje me kualifikimin e operatorëve ekonomik “Rej” sh.p.k, “Sanitary Cleaning” sh.p.k dhe “Pastrime Silvio” sh.p.k., nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimuesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt prokurimi, duke qënë se në renditjen përfundimtare, para tij qëndron një tjetër operator ekonomik i kualifikuar.

Në këto kushte, KPP gjykon që pretendimet e ankimuesit nuk do të merren në shqyrtim

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave* “*Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Clean Fast" sh.p.k për procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur", me Nr.REF-55708-04-06-2020, me objekt: "*Shërbim i pastrimit të ambienteve të brendëshme dhe të jashtme të Spitalit Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë*", me fond limit 76,876,340.6 leke pa tvsh, zhvilluar me date 30.04.2020, nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Të mospranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "Sori-AL" sh.p.k për procedurën e prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik "Alpen Pulito" sh.p.k, duke e skualifikuar atë.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "Clean Fast" shpk.
6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 526 Protokolli;** **Nr. 534 Protokolli;**
**Datë 05.06.2020** **Datë 08.06.2020**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

| Anëtar | Anëtar | Anëtar |
| --- | --- | --- |
| **Vilma Zhupaj** | **Lindita Skeja** | **Merita Zeqaj** |

**Nënkryetar**

**Enkeleda Bega**